



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM GJIROKASTËR

A N A L I Z Ë

E TREGUESVE KRYESORË TË PUNËS SË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË
SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM GJIROKASTËR
PËR VITIN 2024

PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM
z. Olsian ÇELA

I. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT GJATË VITIT 2024

➤ Të dhëna për realizimin e objektivave prioritare të prokurorisë

Në zbatim të detyrimeve ligjore të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjin Nr.97, datë 06.10.2016 *“Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”*, Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, Kodin Penal Ushtarak, Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave *“Për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024”*, dhe planit të veprimit për zbatim miratuar me Udhëzimin nr.05/2024 dt.16.05.2024 *“Per rekomandimet prioritare ne luften kunder kriminalitetit per vitin 2024 ne prokurorite e juridiksionit te pergjithshem”* dhe Urdhërit nr.53, datë 16.05.2024 *“Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024”* dhe planeve të veprimit për zbatimin e tyre, si dhe në mbështetje të kuadrit ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar, duke pasur parasysh edhe praktikën e GJEDNJ, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër është fokusuar dhe i ka dhënë prioritet këtyre drejtimeve kryesore:

- Rritja e efikasitetit në luftën kundër krimit të organizuar dhe forcimin e bashkëpunimit me Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
- Rritja e efikasitetit në luftën kundër pastrimit të parave dhe krimeve financiare dhe kontrabandës së mallrave.
- Rritja e efikasitetit ndaj veprave penale me bazë gjinore, dhunës në familje, kundër fëmijëve dhe masat e marra për mbrojtjen e viktimave të këtyre veprave penale.
- Rritja e bashkëpunimit ndërinstitutional.
- Garantimi i pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së prokurorëve në kryerjen e detyrës.
- Lufta kundër korrupsionit.
- Rritja e rolit aktiv të prokurorit në hetimin paraprak, në funksion të shtimit të hetimeve të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë.
- Zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta me institucione/agjensi ligjzbatuese.
- Rritja e efikasitetit të veprimtarisë administrative të prokurorisë dhe të veprimtarisë së prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në ushtrimin e funksioneve të tyre.
- Mirëfunksionimin e punës në prokurori dhe shpërndarjen e drejtë dhe transparente të çështjeve, sipas kriterëve të përcaktuara nga Prokurori i Përgjithshëm, si dhe identifikimin dhe përmirësimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve.
- Përmirësimi dhe mbajtja e të dhënave statistikore, rregjistrave fizike dhe elektronik si dhe përditësimit të të dhënave mbi ngarkesën e prokurorëve.
- Përmirësimi i marrëdhënieve me publikun dhe median në lidhje me informacionet e kërkuara dhe zbatimin e ligjit Nr.119/2014 *“Për të drejtën e informimit”* për ngjarje të rënda kriminale dhe ato që prekin interesin publik, si dhe aktivitetet e ndryshme të zhvilluara në prokurori.
- Zbatimin me rigorozitet të ligjit Nr.79/2020 *“Për ekzekutimin e vendimeve penale”*, duke marrë masat e nevojshme për nxjerrjen sa më të shpejtë të urdhërave të ekzekutimit dhe vënien në ekzekutim të vendimeve.
- Garantimin për zbatimin e ligjit Nr.81/2020 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, në lidhje me kërkesat për takim nga ana e familjarëve dhe personave të afërt të të paraburgosurve.

Krahas këtyre prioriteteve, gjatë vitit 2024 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë është punuar dhe për ecurinë më të shpejtë të çështjeve në gjykim duke u marrë masat e nevojshme për garantimin e pjesëmarrjes së prokurorit në seancat gjyqësore duke shmangur kështu zvarritjen e çështjeve dhe garantuar të drejtat e viktimave, personave në hetim apo të pandehurve për një proces të rregullt ligjor.

Me anë të urdhërave të brendshëm është bërë e mundur ndarja e punës, drejtimi dhe kontrolli i veprimtarisë së administratës së prokurorisë dhe cilësisë së punës.

Ka pasur problematik për hedhjen e të dhënave në sistemin PRESTO në zbatim të Urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm Nr.92, datë 30.07.2021 *“Për përdorimin e regjistrit elektronik dhe përfitimit të statistikave për çështje të pastrimit të parave në prokuroritë e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm”*, dhe me urdhërin Nr. të Drejtuesit të Prokurorisë për *“Caktimin e prokurorit përgjegjës për sistemin PRESTO”* është caktuar një prokuror përgjegjës dhe një oficer ndihmës për përpunimin dhe raportimin e këtyre të dhënave, masë që do të përmirësojë gjendjen e tyre në të ardhmen.

➤ Roli aktiv i prokurorit dhe hetimet proaktive

Nga prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë janë kryer hetime proaktive bazuar dhe në kërkesat dhe referimet e shërbimeve të policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit, ku pjesën kryesore e përbëjnë veprat penale kundër kultivimit apo prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike, kundër krimeve financiare dhe kontrabandës së mallrave dhe krimeve kundër jetës dhe atyre të kontrabandimit të personave të huaj, kryesisht emigrantë nga vendet MENA të cilët e përdorin territorin e Republikës së Shqipërisë si tranzit drejt vendeve të Bashkimit Europian.

Bazuar në të dhënat statistikore, rezulton se gjatë vitit 2024 janë regjistruar 24 procedime penale për kryerje veprimesh proaktive për vepra të ndryshme penale parashikuar nga nenet 284, 283/2, 298/3, 174, 178, 76, 248, 332/a etj. të Kodit Penal, dhe duke përfshirë çështjet e mbartura proaktive rezulton që gjatë vitit 2024 të jenë hetuar 30 procedime penale proaktive.

Në funksion të këtyre procedimeve penale janë kryer një numër i madh veprimesh hetimore duke përdorur metoda speciale të hetimit si përgjimi i telekomunikimeve, vëzhgimi në ambientet publike, përgjimi ambiental dhe vëzhgimi me kamera, hetime këto që kanë rezultuar të sukseshme dhe është arritur të zbulohet aktiviteti kriminal i një numri të lartë personash të cilët janë arrestuar, ku bëjnë pjesë edhe funksionarë publikë, punonjës të strukturave të Policisë së Shtetit si në rolin bazë ashtu dhe në atë drejtues me grada kryekomisar.

Vlen të theksohet puna e prokurorëve, oficerëve të ngarkuar me hetimin e këtyre çështjeve, strukturave të Forcës së Posaçme Operacionale në DPPSH si dhe oficerëve të SPTMSHI në Prokurorinë e Përgjithshme për koordinimin dhe realizimin e teknikave dhe operacioneve për vënien përpara përgjegjësisë penale të personave të përfshirë në aktivitete kriminale.

➤ Zbatimi i Udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm

Në zbatim të udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë janë nxjerrë një sërë urdhërash dhe vendimesh për organizimin dhe mirëfunksionimin e punës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, si psh. *Caktimi i*

prokurorit të medias, caktimi i prokurorit të seksionit për të mitur, caktimi i prokurorit përgjegjës për sistemin PRESTO, etj, të cilat kanë ndikuar dukshëm në përmirësimin e procesit normal të punës në Prokurori.

➤ Zbatimi i Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave

Në kuadër të zbatimit të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër në kuadër të masave procedurale të marra në fazën e hetimeve, ushtrimit të ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës në gjyq, janë nxjerrë udhëzime jo të detyrueshme për çështje konkrete në 5 raste si dhe në 10 raste është kërkuar informacion për ecurinë e hetimeve për çështje konkrete nga më problematikat perfshi ketu edhe për rastet e çështjeve të mbartura nga vitet e kaluara të cilat rrisin ngarkesën e çdo prokurori dhe çënojnë interesat e palëve në proces.

Janë organizuar 11 mbledhje me prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të seksionit të prokurorisë me tematike të caktuar në të cilat janë trajtuar problematika të veçanta. Nga këto takime janë evidentuar mangësitë e vërrejtura në punën e oficerëve por edhe mungesa e logjistikës për ti mbështetur ata në kryerjen e detyrave. Konstatohet se për periudha të gjata kohe oficerët e policisë gjyqësore në Komisariat ngarkohen me detyra për kontrollin e territorit dhe asgjësimin e bimëve narkotike që kultivohen në territorin ku ushron aktivitetin kjo Prokurori, ka levizje të shpeshta të oficerëve të policisë gjyqësore të shërbimeve të policisë gjë që bën që shpesh herë të neglizhohen detyrat prioritare në hetimin e çështjeve duke sjellë zvarritje të hetimeve paraprake dhe duke çënuar cilesinë e këtyre hetimeve. Është tërhequr vëmendja e oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit për zvarritje të hetimeve për raste konkrete dhe nga Drejtuesi Prokurorisë konkretisht në 5 raste është urdhëruar kryerja e veprimeve hetimore të nevojshme në kuadër të këtyre çështjeve.

Nga Drejtuesi i Prokurorisë janë nxjerrë 11 urdhëra të brendëshëm dhe 1 vendim, me anë të të cilave është përmirësuar dukshëm procesi normal i punës.

Me synim garantimin e një ngarkese të barabartë për prokurorët është ndjekur me përparësi shpërndarja e çështjeve në prokurori nëpërmjet sistemit CAMS, po kështu për të gjitha rastet e çështjeve të veçanta, kryesisht atyre të dorëzuara nga prokurorët e transferuar është aplikuar me korrektësi dhe transparencë procedura e shortimit manual të tyre.

Është zbatuar me korrektësi raportimi periodik 3 mujor i të dhënave statistikore dhe raportimit 2 mujor në sistemin SVHOPGJP.

Përveç sistemit TIMS dhe E-Albania kemi akses edhe në databazet e ASHK-se dhe Drejtorise të Përgjithshme të Burgjeve gje që ka ndikuar në efektivitetin e hetimeve.

Po kështu janë në hetim edhe disa çështje që lidhen me veprime abuzive të nepunësve shtetërore në disa prej institucioneve që përfshihen në Qarkun e Gjirokastres. Duke qenë se kjo kategori veprash penale mbeten prioritare për këtë Prokurori është kushtuar kujdes që politikat e ndjekura në hetimin, gjykimin dhe denimin të jenë të tilla që ti shërbejnë jo vetëm ndeshkimit por edhe parandalimit të këtyre fenomeneve, ku gjatë 3 muajve të tretë 2024 është dërguar për gjykim ish-drejtori i ASHK Drejtoria Vendore Gjirokastër dhe 2 bashkëpunëtorë të tij të akuzuar për veprën penale “Falsifikimi i dokumentave”, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal dhe më herët janë dërguar për gjykim 9 punonjës policie të akuzuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

➤ Respektimi i të drejtave të njeriut dhe interesave të ligjshme të shtetasve në procesin penal

- Në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut dhe interesave të ligjshme të shtetasve në procesin penal, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër si institucion por edhe nga ana e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore është mbajtur parasysh dhe është treguar kujdes i veçantë në lidhje me garantimin dhe njohjen me të drejtat të të pandehurve, personave në hetim dhe viktimave dhe përfaqësimin nga mbrojtësi në rastet kur nuk është e mundur financiarisht nga i pandehuri apo personi në hetim.

- Është garantuar pjesëmarrja e psikologut në të gjitha rastet e nevojshme dhe është kërkuar nga ana e tyre përpilimi i raporteve të vlerësimit të rasteve në një kohë sa më të shpejtë për marrjen e masave të nevojshme nga ana e organit të prokurorisë.

- Fokusi i prokurorisë dhe prokurorëve gjatë këtij viti por dhe në vazhdim ka qënë dhe është kryerja e veprimeve hetimore dhe përfundimi i çështjeve penale në një periudhë sa më të shpejtë duke garantuar hetime të gjithëanëshme, cilësore dhe shteruese.

Dhuna në familje mbetet një problem i theksuar social dhe shoqëror, ku pavarësisht se ndëshkushmëria ka qënë e lartë, ky fenomen negativ i shoqërisë nuk ka përparimet e duhura dhe nga ana e viktimave të këtyre veprave penale ka një hezitim në kallzimin e tyre. Shkaku kryesor i dhunës në familje është gjendja e dobët ekonomike dhe probleme të tjera sociale.

➤ Të miturit në konflikt me ligjin, viktimat dhe dëshmitarë, Grupet e vulnerabël të pandehur dhe viktimat

- Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm është ngritur dhe funksionon Seksioni për të Miturit, i përbërë nga një prokuror, një oficer dhe koordinatorja. Gjatë vitit 2024 prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore të seksionit për të mitur kanë marrë pjesë në trajnime të zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës dhe organizata të tjera që kanë në fokus të drejtat e të miturve. Po gjatë kësaj periudhe prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore kanë marrë pjesë regullisht në takimet lokale ndërmjet institucioneve vendore dhe policisë për diskutimin e rasteve të veçanta dhe personave në situata delikate sociale.

- Gjatë vitit 2024 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër ka marrë të gjitha masat ligjore dhe procedurale në zbatimin të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, Kodit Penal, Kodit të Procedurës Penale, për të garantuar një proces hetimor penal për të miturit në konflikt me ligjin, viktimat ose dëshmitarë, transparent, të shpejtë dhe shterues.

➤ Bashkëpunimi ndërinstitucional

- Gjatë vitit 2024 ka pasur një bashkëpunim të frytshëm, korrekt dhe brenda kuadrit ligjor me Prokurorinë e Përgjithshme, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Shërbimin Informativ Shtetëror, Drejtorinë Vendore të Policisë Gjirokastër, Komisaritet e Policisë Gjirokastër, Tepelenë dhe Përmet, Agjensinë e Mbikëqyrjes Policore Rajoni Vlorë-Gjirokastër si dhe me Drejtorinë Vendore për Kufirin dhe Migracionin.

- Janë zhvilluar takime periodike ndërmjet Drejtuesit të Prokurorisë dhe drejtuesve të policisë dhe shërbimeve të policisë gjyqësore si dhe agjensive të tjera ligjzbatuese, në lidhje me çështje konkrete dhe problematika të hasura gjatë hetimeve dhe ecurinë e çështjeve.

- Gjithashtu janë zhvilluar takime të përbashkëta me institucione të tjera si Prefekti i Qarkut Gjirokastrë dhe Bashkitë e Qarkut Gjirokastrë (Gjirokastrë, Tepelenë, Përmet, Libohovë, Memaliaj, Këlcyrë dhe Dropull), Agjensinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtuar Gjirokastrë, kryesisht për luftën kundër fenomenit të kultivimit të bimëve narkotike dhe masat e marra kundër këtij fenomeni si dhe në luftën kundër krimeve mjedisore, zjarrvënies të qëllimshme të sipërfaqeve pyjore apo fondeve kullosore dhe kundër gjuetisë së paligjshme.
- Është mbajtur marrëdhënie korrekte dhe profesionale me zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në lidhje me të dhënat e kërkuara për ankesat e depozituara nga qytetarët por edhe në lidhje me procedurën e inspektimit tematik të shpërndarjes së çështjeve.

➤ Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja

- Gjatë vitit 2024 marrëdhëniet juridiksionale me autoritet e huaja gjyqësore kanë qënë në nivele të larta dhe bashkëpunim ka qënë i frytshëm, ku në një prej tyre është kërkuar ndihmë juridike autoriteteve gjyqësore të Maqedonisë së Veriut në lidhje me marrjen në pyetje të disa personave për ngjarjen e rëndë në qytetin Memaliaj në muajin korrik 2024 ku në një atentat janë vrarë me armë zjarri 3 shtetas dhe është plagosur një tjetër. Në këtë rast veprimet kanë qënë të ngutshme dhe shpjeguesia e kryerjes së tyre kishte rëndësi për zhvillimin e hetimeve. Kjo procedurë është kryer nëpërmjet ndihmës së prokurorit ndërlidhës në EUROJUST dhe Prokurorisë së Përgjithshme.
- Komunikimet periodike dhe shkëmbimi i të dhënave me autoritetet e huaja ka qënë korrekt dhe i shpejtë si në rastin e lëtrëporosive nga jashtë ashtu dhe për lëtrëporositë e dërguara jashtë.
- Vlen të theksohet puna shumë e mirë e Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme dhe po ashtu dhe ajo e Ministrisë së Drejtësisë.
- Janë zhvilluar takime me përfaqësues të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Ambasadës së Mbretërisë së Hollandës me tematika të ndryshme mbi ecurinë dhe përmirësimin e hetimit, zbatimin e ligjit, pavarësinë e prokurorëve dhe garancitë në kryerjen e detyrës së tyre.
- Në fushën e bashkëpunimit me autoritet e huaja gjyqësore, është kryer procedura e kthimit të sendeve të vjedhura në një muze në Greqi dhe trafikuar në Shqipëri, ku pala greke përfaqësohej nga prokurori i Prokurorisë së Apelit Janinë, përfaqësues së Ministrisë së Kulturës së Greqisë dhe Konsulli grek në Gjirokastrë.

➤ Të dhënat për temat dhe numrin e trajnimeve të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore

Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore kanë marrë pjesë në trajnime të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës dhe organizata të tjera si OSBE, USAID, etj, me temat:

- “Mekanizmi i referimit në ndërmjetësim”
- “Cybercrime and Electronic Evidence”
- “Trafikimi i qënieve njerëzore, personave të rritur dhe të mitur”
- “Kudri ligjor ndërkombëtar dhe standartet ndërkombëtare”
- “Format e kryerjes së veprës penale të trafikimit”
- “Risitë në pozicionin procedural të viktimave”
- “Metodikat, teknikat e posaçme në kryerjen e hetimeve të trafikimit”
- “Identifikimi dhe intervistimi i viktimave”
- “Specifikat e intervistimit të të miturve, viktimave të trafikimit”
- “Juriciary in the context of fighting of illicit trafficking of cultural property in Albania.”
- “Trafikimi i qënieve njerëzore”

- *“Korrupsioni me përfitimi të parregullt dhe aferat me tendera. Hetimin dhe gjykimin e veprave penale lidhur me fushën e prokurimeve publike.*
- *“Bashkëpunimi me EUROJUST”*
- *“Hetimi proaktiv, Kuadri ligjor. Burimet e informacionit për hetimet kriminale të bazuara në inteligjencë. Procedura që ndiqet për regjistrimin dhe ecurinë e procedimeve proaktive. Standartet dhe praktikat e mira ndërkombëtare”*
- *“Zbatimi i marrëveshjes të transferimit të personave të dënuar në Mbretërinë e Bashkuar”*
- *“Hetimi Proaktiv, Përgjimet”*
- *“Asistenca ndaj të miturit viktimë dhe dëshmitar”*
- *“Teknikat miqësore të intervistimit me të miturit që janë viktimë të abuzimit seksual”*
- *“Seminar për koordinatorët e sistemit e-tracking për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin”*

II. ANALIZA E TREGUESVE TË KRIMINALITETIT DHE PUNËS SË PROKURORISË

➤ Volumi i punës në hetim

Gjatë vitit 2024, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër ka regjistruar 1241 kallzime nga të cilat janë regjistruar 774 procedime penale me 474 persona nën hetim nga të cilët 79 në masën e sigurisë *“arrest në burg”*. Nga vitit 2023 janë mbartur në hetim 857 procedime penale me 325 persona nën hetim nga të cilët 48 në masën e sigurimit *“arrest në burg”*.


Në total gjatë vitit 2024 janë hetuar 1631 procedime penale me 799 persona nën hetim nga të cilët 127 në masën e sigurisë *“arrest në burg”*.

Gjatë vitit 2024 janë përfunduar 860 procedime penale me 168 persona nën hetim dhe 364 të pandehur nga të cilët 81 në masën e sigurisë *“arrest në burg”* dhe janë mosfilluar 427 kallzime penale.

Për vitin 2025 u mbartën në hetim 771 procedime penale me 267 persona nën hetim nga të cilët 46 në masën e sigurisë *“arrest në burg”*.

Duke marrë në konsideratë objektivat për vitin 2024 mund të themi se janë realizuar në një masë të kënaqshme pasi janë realizuar disa nga objektivat, një ndër të cilat ishte dhe ulja e numrit të çështjeve të mbartuara. Pavarësisht se nuk është një diferencë e madhe midis çështjeve të mbartura nga 2023 në 2024 me atë të mbartura nga 2024 në 2025, vlen të theksohet se gjatë 2024 janë regjistruar 156 procedime penale ose 25% më shumë se viti 2023 dhe janë përfunduar 53% çështje më shumë se gjatë vitit 2023.

Paraqitje grafike e të dhënave të mësipërme:



➤ **Çështje të përfaqësuara në gjykim**

Gjatë vitit 2024 janë përfaqësuar në gjykim **664** çështje me **751** persona të pandehur nga të cilët 138 në masën e sigurisë “*arrest në burg*”, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

Kanë përfunduar gjatë këtij viti **377** çështje me 435 të pandehur dhe janë mbartuar për vitin pasardhës **287** çështje me 320 të pandehur nga të cilët 33 në masën e sigurisë “*arrest në burg*”


Nga çështjet e përfunduara rezulton të jenë gjykuar si më poshtë:

Gjykim i drejtëpërdrejtë: 4 çështje me 4 të pandehur

Gjykim i zakonshëm: 10 çështje me 16 të pandehur

Gjykim i shkurtuar: 358 çështje me 415 të pandehur

Paraqitje grafike



➤ Treguesit kryesor të punës së prokurorisë

Volumi i punës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër gjatë vitit 2024 ka qënë **1631** procedime në hetim me 799 persona në hetim nga të cilët 126 me masën e sigurisë “*arrest në burg*”, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

Kanë përfunduar gjithsej gjatë vitit raportues **860** çështje me 168 persona në hetim, 364 të pandehur, nga të cilët 81 në masën e sigurisë “*arrest në burg*”.

Mbraten për vitin pasardhës **771** procedime penale me 267 persona në hetim nga të cilët 46 në masën e sigurisë “*arrest në burg*”.

Çështjet e përfunduara ndahen si më poshtë:

Mosfillime: 427 kallzime penale


Pushuar: 253 procedime penale me 77 persona nën hetim

Pezulluar: 136 procedime penale me 2 persona nën hetim

Transferuar: 150 procedime penale me 89 persona nën hetim, 3 “arrest në burg”

Dërguar për Gjykim: 321 procedime penale me 364 të pandehur, 78 “arrest në burg”

Paraqitje grafike



➤ Njoftimet e veprave penale

Gjatë vitit 2024 janë regjistruar **1241** kallzime/referime të veprave penale. Pjesën më të madhe të këtyre njoftimeve e zënë shërbimet e Policisë së Shtetit me **1050** referime të ngjarjeve kriminale apo të kallzimeve të shtetasve. Nga shtetasin janë paraqitur **160** kallzime penale kryesisht nëpërmjet shërbimit postar apo depozitimit në sekretari. Janë referuar në prokurori **12** materiale procedurale nga Agjensia e Mbikëqyrjes Policore. Janë paraqitur **17** kallzime penale nga Nëpunësit Publik. Janë filluar kryesisht nga prokurori **2** çështje veprat penale të parashikuara nga nenet 248 dhe 306/1 të Kodit Penal.

Veprat më të përhapura dhe më të zakonshme që janë regjistruar gjatë vitit 2024, janë ato që kanë të bëjnë me shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor, shkeljes së kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë, vedhjes së pasurisë, prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike, etj., parashikuar nga nenet 290, 291, 297, 134, 283 etj. të Kodit Penal

Veprat penale më të kallzuara nga qytetarët, janë ato që kanë të bëjnë me shëprдорimin e detryrës dhe falsifikimin e dokumentave. Gjatë vitit 2024 nga qytetarët nuk është kallzuar asnjë rast korrupsioni.



Janë regjistruar 2 raste korrupsioni për veprën penale 244/1 të Kodit Penal, referuar nga Policia e Shtetit dhe është regjistruar 1 kallzim i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për një ish-gjyqtare të shkaruar nga institucionet e vettingut për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a të Kodit Penal.

Nenet	Nr. Ref/Kall	Nenet	Nr. Ref/Kall	Nenet	Nr. Ref/Kall	Nenet	Nr. Ref/Kall	Nenet	Nr. Ref/Kall
76	1	108/2	1	139	1	206/b/1	3	248	51
78/1	1	108/a/1	4	141/a/1	10	206/a/1	11	250	3
79-dh	2	109/b/1	3	143/1	21	206	2	257/a/1	1
80	1	110/1	3	143/2	1	207/a	3	267	1
84	28	112/1	7	143/3	2	207/b	3	272	3
88	5	117/2/1	3	143/b/1	3	207/c	4	273	3
89	19	118	4	150	50	214	1	274	1
90	50	119/1	7	151	63	236/1	4	274/b	1
91	1	121	4	160/1	1	237	3	275	2
96	1	121/a/1	5	161	5	238	2	277	10
99	33	121/a/2	2	170/a/1	1	242	5	278/1	3
100/1	1	124/1	5	170/ç/1	1	244/1	2	278/3	1
101/1	2	124/b/1	1	171	3	248	51	279/2	3
108/2	1	125	1	172/1	2	250	3	280	6
108/a/1	4	127	5	173/1	2	257/a/1	1	283/1	44
109/b/1	3	130/a/1	23	174/1	11	267	1	283/2	8
110/1	3	130/a/4	9	174/2	1	272	3	283/a/2	1
112/1	7	134/1	99	178/1	2	273	3	284/1	11
117/2/1	3	134/2	5	178/2	1	274	1	287	14
118	4	134/3	1	179/a	14	278/1	3	288/2	1
119/1	7	135	2	180/1	8	279/2	3	289/1	4
121	4	137/1	10	183/1	1	280	6	290/1	76
121/a/1	5	138/1	1	186/1	18	283/2	8	290/2	5
121/a/2	2	139	1	186/2	1	283/a/2	1	290/3	4
124/1	5	141/a/1	10	186/a/1	3	284/1	11	290/4	2
124/b/1	1	143/1	21	188/1	1	287	14	291	96
125	1	143/2	1	189/2	1	288/2	1	293	2
127	5	143/3	2	190/1	3	289/1	4	297	155
130/a/1	23	143/b/1	3	192/b/1	1	290/1	76	298/1	3
130/a/4	9	150	50	197	1	290/2	5	298/3	12
134/1	99	151	63	199	4	290/3	4	301	1
134/2	5	160/1	1	199/a/1	20	290/4	2	302	1
134/3	1	161	5	199/a/2	3	291	96	305	4
135	2	170/a/1	1	199/a/3	2	305/b	1	306/1	1
137/1	10	170/ç/1	1	200	16	309/1	1	317	1
138/1	1	171	3	202/1	2	320	4	320/a/1	3
139	1	172/1	2	202/b	2	321/2	1	323	7

➤ Të dhëna për masat e sigurimit

Gjatë vitit 2024 nga shërbimet e policisë gjyqësore të seksionit të policisë së shtetit janë kryer **145** arrestime në flagrancë dhe **6** ndalime me iniciativë. Nga ana e prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjyrosatër janë nxjerrë **37** urdhëra ndalimi. Për **1** rast është urdhëruar lirimi i menjëhershëm i të arrestuar dhe **12** arrestime/ndalime janë nxjerrë të paligjshme nga gjykata. Nga prokurorët janë apeluar **18** vendime kundër zbutjes apo vleftësimit të masave të sigurimit, ku vendimmarrja e Gjykatës së Apelit kryesisht ka qënë në favor të ankimit të prokurorit.

Paraqitje grafike e masave të sigurimit



Gjatë vitit 2024 nuk ka pasur asnjë rast ku të jetë kërkuar pushimi i çështjes apo akuzës dhe personi në hetim të ketë qënë në masën e sigurisë arrest në burg ose arrest në shtëpi.

➤ Të dhëna në lidhje procedimet dhe hetimet pasurore dhe masat e marra

Gjatë vitit 2024 janë hetuar një numër i madh i procedimeve penale për veprën “*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*”, si dhe të hetimeve pasurore në bazë të ligjit Nr.10192/2009.

Përkatësisht gjatë vitit 2024 janë referuar **14** materiale për veprën penale të parashikuar nga neni 287 dhe për ligjin Nr.10192/2009, mbi bazën e të cilave janë regjistruar **8** procedime penale për veprën penale “*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal dhe 6 hetime pasurore në bazë të ligjit Nr.10192/2009.

Në total duke përlogaritur dhe procedimet e mbartura nga vitet paraardhëse rezulton se janë hetuar **58** procedime penale për nenin 287 të Kodit Penale dhe **85** hetime pasurore.

Nga këto çështje janë përfunduar **6** procedime penale për veprën penale “*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*”, si më poshtë:

- Për **3** çështje është kërkuar pushimi.
- **2** çështje janë transferuar për kompetencë.
- **1** çështje është kërkuar gjykimi, çështje e cila është dërguar për gjykim në vitet e kaluar por e deklaruar në statistikë gjatë 2024. Në këtë rast gjykata ka dhënë pafajësi.

Ka përfunduar **1** hetim pasuror i cili është pushuar dhe nuk është kryer asnjë sekuestro në funksion të këtyre lloj hetimesh.

Vlen të theksohet se janë kryer një numër i madh veprimesh hetimore dhe mbledhje të dhënash nga institucione të ndryshme dhe gjatë vitit 2025 do të kryhen ekspertimet financiare për këto çështje dhe në bazë të rezultateve të ekspertimeve do të vlerësohet vendosja e sekuestros së pasurive të krijuara nga aktivitetet kriminale.

➤ Kriminaliteti sipas shtrirjes territoriale të njësive administrative

Qarku Gjirokastrë ka një shirje sipërfaqe prej 2884 m² përbëhet kryesisht nga reliev kodrinor-malor dhe përfshin rrethin e Gjirokastrës, rrethin e Tepelenës dhe rrethin e Përmetit.

Rrethi Gjirokastrë ka në përbërje bashkitë Gjirokastrë, Libohovë dhe Dropull.

Rrethi Tepelenë ka në përbërje bashkitë Tepelenë dhe Memaliaj.

Rrethi Përmet ka në përbërje bashkitë Përmet dhe Këlcyrë.

Popullsia e qarkut Gjirokastrë sipas të dhënve të marra nga INSTAT në vitin 2023 ka qënë 53,314 banorë.

Qarku Gjirokastrë kufizohet në Veri Perëndim me Qarkun e Fierti, në Veri Lindje me Qarkun e Beratit, në Lindje me Qarkun e Korçës, në Perëndim me Qarkun e Vlorës dhe në Jug me shtetin Grek.



Rreth 50% e referimeve nga strukturat e policisë së shtetit dhe kallzimeve nga qytetarët vijnë dhe bëjnë fjalë për ngjarje të ndodhura në rrethin e Gjirokastrë.

Rreth 35% e referimeve nga strukturat e policisë së shtetit dhe kallzimeve nga qytetarët vijnë dhe bëjnë fjalë për ngjarje të ndodhura në rrethin e Tepelenës.

Rreth 15% e referimeve nga strukturat e policisë së shtetit dhe kallzimeve nga qytetarët vijnë dhe bëjnë fjalë për ngjarje të ndodhura në rrethin e Përmetit.

➤ Kriminaliteti sipas peshës/përhapjes së veprave penale dhe tendencave të tyre.

Në një këndvështrim të përgjithshëm veprat penale më të përhapura dhe të regjistruara gjatë vitit 2024 kanë qenë:

Veprat penale kundër rendit, sigurisë publike dhe autoritetit të shtetit gjithsej 333 procedime nga të cilat 9 procedime për “Kultivim të bimeve narkotike”, parashikuar nga neni 284 i K.Penal, 26 procedime për “Prodhim dhe shitje të narkotikeve”, parashikuar nga neni

283 i K.Penal, **27** procedime për “Shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor” parashikuar nga neni 290 i K.Penal, **97** procedime për veprën penale “Drejtimi automjeteve në mënyrë të parregullt” parashikuar nga neni 291 i K.Penal, **6** procedime për nenet 278, 278/a, 279, 280 të K.Penal, **16** procedime për nenin 298 të K.Penal, **143** procedime për nenin 297 të K.Penal dhe **9** procedime për nenin 287 të K.Penal etj,

Veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike gjithsej **174** procedime ku numrin më të madh e zënë ato të parashikuara nga neni 134 i K.Penal (vjedhje pasurisë) me **87** procedime të regjistruara, për nenin 137 i Kodit Penal (Vjedhje energjisë elektrike) **10** procedime, (veprat penale që cenojnë regjimin juridik të tokës dhe të ndertimeve) **22** procedime, për nenet 150-162 (shkatërrimi prones) **42 procedime**, neni 143 i Kodit Penal (mashtrimi) **13** procedime.

Krimet kundër jetës dhe shëndetit, gjithsej **58** procedime, përkatësisht, **2** procedime penale për nenin 79/dh të Kodit Penal, **1** procedim penal për nenin 78 të Kodit Penal, **1** procedim penal për nenin 76 të Kodit Penal, **4** procedime për nenin 88 të Kodit Penal, **19** procedime penale për nenin 89 të Kodit Penal, **31** procedime penale për vepra penale kundër familjes të parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal dhe **1** procedim penal për nenin 90 të Kodit Penal.


Veprat penale kundër drejtësisë gjithsej **16** procedime të regjistruara, përkatësisht, **6** procedime penale për nenin 323 të Kodit Penal, **3** procedime penale për nenin 320 të Kodit Penal, **2** procedime penale për nenin 305 të Kodit Penal dhe nga **1** procedim penal për nenet 321, 306, 301, 302 dhe 309 të Kodit Penal.

Krimet kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetëror gjithsej **23** procedime, përkatësisht **20** procedime penale për nenin 248 të Kodit Penal, **2** procedime penale për nenin 250 të Kodit Penal dhe **1** procedim penal për nenin 257/a të Kodit Penal kundër një ish-gjyqtari të shkarkuar nga vettingu.

Krimet në fushën e falsifikimit të dokumentave gjithsej **16** procedime penale, përkatësisht **11** procedime për nenin 186 të Kodit Penal, **2** procedim për nenin 186/a/1 të Kodit Penal, **3** procedime për nenin 190/1 të Kodit Penal, **1** procedim për nenin 191/1 të Kodit Penal.


Krimet në fushën doganore gjithsej **29** procedime penale, përkatësisht **14** procedime për nenin 179/a të Kodit Penal, **8** procedim për nenin 174 të Kodit Penal, **3** procedime për nenin 178/1 të Kodit Penal dhe nga **1** procedim penal për nenet 171, 172, 173, 175 të Kodit Penal.

Paraqitje grafike




Në krahasim me vitin 2023, gjatë vitit raportues 2024 kemi një tendencë në ulje të veprave penale të “*kultivimit të bimëve narkotike*” dhe “*ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit*”, një rritje të lehtë të ngjarjeve me vjedhje dhe dyfishim të rasteve të shkatërrimit të pronës dhe kalimit të paligjshëm të kufirit. Veprat e tjera kanë përgjithësisht të njëjtat vlera, me diferenca deri në +- 10 procedime nga viti në vit. Më poshtë do të gjeni dhe paraqitjen grafike krahasimore të veprave penale të regjistruara.

Paraqitje e garfikut krahasues



➤ **Kriminaliteti sipas strukturës së Kodit Penal(krime-kundërvajtje)**

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër gjatë vitit 2024 janë regjistruar **774** procedime penale. Sipas të dhënave në regjistrat fizik dhe elektronik të veprave penale rezulton se ndarja strukturore sipas kodit penal, i çështjeve të regjistruara gjatë vitit 2024 është **194** çështje të regjistruara përbëjnë kundërvajtje penale dhe **580** çështje të regjistruara janë krime.



III. TREGUESIT STATISTIKORE 2 VJEÇAR TË VEPRAVE PENALE SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL


➤ Të dhëna krahasimore

Gjatë vitit 2024 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër ka regjistruar **774** procedime penale. Në krahasim me vitin 2023 ka një rritje prej **25%** të numrit total të çështjeve të regjistruara.

Gjatë vitit 2024 janë hetuar në total bashkë me çështjes e mbartura **1631** procedime penale, nga të cilat janë përfunduar **860** çështje. Në krahasim me vitin 2023 ka një rritje prej **53%** të çështjeve të përfunduara.

Sipas treguesve statistikorë ka një rritje të dukshme në krahasim me vitin 2023 si të ngarkesës më të lartë të çështjeve në hetim, **156** procedime penale të regjistruara më shumë, si dhe të çështjeve të përfunduara **296** procedime penale të përfunduara më shumë.

Më poshtë në paraqitje grafike do të gjeni të dhëna krahasimore 2 vjeçarë sipas strukturës së Kodit Penal.



Çështje të dërguara në gjykim

Gjatë vitit 2024 janë dërguar për gjykim **321** procedime penale me **364** të pandehur, si më poshtë vijon:

- **6** kërkesa për miratim të marrëveshjes së fajësisë me 7 të pandehur.
- **16** kërkesa për miratimin e urdhërit penale me 16 të pandehur.

- **299** kërkesa për dërgim në gjyq me 341 të pandehur.

Në krahasim me vitin 2023 ku në gjykim ishin dërguar **290** procedime penale, në vitin 2024 ka një rritje prej **31** procedime penale ose rreth **10%** më shumë.

Çështje të pushuara

Gjatë vitit 2024 janë pushuar me vendim të prokurorit ose janë dërguar në gjykatë me kërkesë për pushim **253** procedime penale me 77 persona në hetim, si më poshtë vijon:

- **113** procedime penale të pushuara për mungesë fakti penal.
- **5** procedime penale të pushuara për mungesë provash.
- **135** procedime penale të pushuara për shkak anmistie dhe heqje dorë të të dëmtuarit nga ankimi.

Në krahasim me vitin 2023 ku janë pushuar **133** procedime penale, në vitin 2024 ka një rritje me **120** procedime penale ose rreth **90%** më shumë, kryesisht për shkak të zbatimit të ligjit nr.33/2024 “Për dhënie amnistie”.

Çështje të pezulluara

Gjatë vitit 2024 janë pezulluar **136** procedime penale me 2 persona në hetim, ndërsa gjatë vitit 2023 janë pezulluar **84** procedime penale.

Në krahasim me vitin 2023, gjatë vitit 2024 ka një rritje të procedime penale të pezulluara me **52** procedime penale ose rreth **62%** më shumë.

Çështje të transferuara

Gjatë vitit 2024 janë transferuar për kompetencë ose bashkuar me procedime të tjera **150** procedime penale me 89 persoan ne hetim, 3 arrest ne burg, ndërsa gjatë vitit 2023 janë transferuar **33** procedime penale me 21 persona në hetim.

Në krahasim me vitin 2023, gjatë vitit 2024 janë transferuar për kompetencë ose bashkuar me procedime të tjera **117** procedime penale më shumë.

Persona në hetim dhe të pandehur

Gjatë vitit 2024 janë hetuar **799** persona në hetim nga të cilët **364** të pandehur, ndërsa gjatë vitit 2023 janë hetuar **658** persona në hetim nga të cilët **340** të pandehur.

Në krahasim me vitin e kaluar gjatë vitit 2024 ka një rritje të numrit të personave në hetim me **141** persona në hetim ose rreth **21%** më shumë dhe rritje të numrit të pandehurve me **24** ose rreth **7%** më shumë.

Të pandehur të dënuar

Gjatë vitit 2024 janë nxjerrë **164** urdhëra ekzekutimi për të pandehur të dënuar me vendim të formës së prerë nga të cilët janë ekzekutuar **151** urdhëra ekzekutimi ose **92%** e tyre, ndërsa gjatë vitit 2023 janë nxjerrë **216** urdhëra ekzekutimi për të pandehur të dënuar me vendim të formës së prerë nga të cilët janë ekzekutuar **182** urdhëra ekzekutimi ose **84%** e tyre.

IV. ANALIZA E TREGUESVE TË EFEKTIVITETIT TË PUNËS SË PROKURORISË


- Treguesi i efektivitetit në hetimin dhe ndjekjen penale dhe raporti midis çështjeve të përfunduara

Gjatë vitit 2024 janë hetuar në total duke përfshirë dhe çështjet e mbartura **1631** procedime penale, nga të cilat kanë përfunduar **860** procedime penale, si më poshtë vijon:


- **Gjykim** – **321** procedime me 364 të pandehur nga të cilët 78 në masë sigurimi arrest në burg.
- **Pushuar** – **253** procedime penale me 77 persona në hetim.
- **Pezulluar** – **136** procedime penale me 2 persona në hetim.
- **Transferuar** – **150** procedime penale me 89 persona në hetim nga të cilët 3 në masë sigurimi arrest në burg.

Janë mbartur për vitin pasardhës **771** procedime penale me **267** persona në hetim, nga të cilët **46** në masën e sigurisë arrest në burg.


Paraqitje grafike




RAPORTI I ÇËSHTJEVE TË PËRFUNDUARA




RAPORTI GJYKUAR/PUSHUAR



RAPORTI PEZULLUAR/PERFUNDUAR



RAPORTI TRANSFERUAR/PERFUNDUAR



➤ Treguesi i efektivitetit në gjykimin dhe dënimin e të pandehurve

Gjatë vitit 2024 kanë qënë në proces gjykimi **664** çështje me **751** të pandehur nga të cilët **138** në masën e sigurisë arrest në burg.

Kanë përfunduar në gjykim **377** çështje me **431** të pandehur nga të cilët **105** në masë sigurimi arrest në burg.


Nga prokurorët në seancë janë kërkuar **103** masa dënimi me gjobë, **132** dënime alternative sipas neneve 59 e 63 të K.Penal, **1** dënim me burgim me masën e paraburgimi, **30** dënime minimale me burg,

64 dënime mesatare me burgim, 2 dënime maksimale me burgim, 2 pushim akuze, 41 pushim çështje dhe 2 pafajësi.

Nga gjykata janë vendosur 103 dënime me gjobë, 1 dënim me masën e paraburgimit, 29 dënime minimale me burgim, 51 dënime mesatare me burgim, 3 dënime maksimale me burgim, 136 dënime alternative, 4 kthim aktesh, 2 pushim akuze, 42 pushim çështje dhe 6 pafajësi.

Nga prokuroria janë ankimuar 14 vendime themeli të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.

Paraqitje grafike



➤ Gjykimet e posaçme dhe ecuria e tyre


Gjatë vitit 2024 janë aplikuar në proces gjykimi dhe ato të posaçme, siç janë gjykimi i drejtëpërdrejtë, gjykimi i shkurtuar, urdhëri penal, marrëveshja e fajësisë.

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër janë aplikuar gjykimet e posaçme si më poshtë vijon:

- **Gjykimi i Drejtëpërdrejtë** – 4 çështje me 4 të pandehur.

- **Gjykimi i Shkurtuar** – 358 çështje me 415 të pandehur.
- **Urdhër Penal** – 16 çështje me 16 të pandehur për të cilat gjykata ka vendosur 11 miratime dhe 2 janë refuzuar, ku një është pushuar dhe për një janë kthyer aktet e dërguar për gjykim
- **Marrëveshje Fajësie** – 6 çështje me 7 të pandehur për të cilat gjykata ka vendosur 3 miratime dhe 2 refuzim dhe kthim aktesh dhe janë dërguar përsëri në gjykatë me kërkesë për gjykim.

Paraqitje grafike



➤ Të dhëna sociale dhe demografike për të pandehurit dhe personat nën hetim dhe viktimat

Gjatë vitit 2024 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjyrokastër ka hetuar **799** persona nga të cilët **364** janë marrë në cilësinë e të pandehurit.

Pjesa dërmuese e personave nën hetim janë të gjinisë mashkullore, jetojnë në zona rurale dhe kanë arsim 9 vjeçar dhe të mesëm, të papunë ose të vetëpunësuar kryesisht në bujqësi dhe blektori dhe shkak kryesor i kryerjes së veprave penale është pikërisht faktori ekonomik dhe social.

Femrat, përbëjnë shumicën e viktimave të veprës, kryesisht asaj të “*dhunës në familje*”, por ka dhe raste të izoluara të dhunës seksuale apo përhapje të të dhënave personale si materiale foto apo video intime.

➤ Të miturit

Gjatë vitit 2024 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjyrokastër ka regjistruar **50** referime për çështje me të mitur.

Janë mosfilluar **16** kallzime ku në një rast është aplikuar këshillimi, në **4** raste është aplikuar paralajmërimi me shkrim bazuar në KDPM dhe në **11** raste është vendosur mofillimi i procedimit penal për shkaqe të tjera bazuar K.Pr.Penale.

Janë regjistruar **34** procedime penale me **38** të mitur në konflikt me ligjin nga të cilët **35** meshkuj dhe **3** femra, **4** të grupmoshës 14-16 vjeç dhe **34** të grupmoshës 16-18 vjeç.

Gjithashtu janë regjistruar edhe **11** çështje me **13** viktime të mitur, **9** të gjinisë femërore dhe **4** të gjinisë mashkullore, nga të cilët **5** me dëmtime të lehta dhe **1** me dëmtime të rënda.


Është aplikuar masë sigurimi për **5** të mitur, ku për **1** të mitur është aplikuar masa e sigurisë arrest në burg, përsëritës në kryerjen e veprave penale, për **2** të mitur është aplikuar masa e sigurisë “arrest në shtëpi” dhe për **2** të mitur është aplikuar lloje të tjera masash sigurimi.

Janë pushuar **22** procedime penale me **22** të mitur në konflikt me ligjin, ku në **21** prej tyre është aplikuar zbatimi i shmangies dhe paralajmërimi me shkrim dhe **1** procedim penal është pushuar për shkaqe të tjera.

Është pezulluar **1** procedim penal.

Janë dërguar për gjykim **6** procedime penale me **7** të pandehur nga të cilët **5** të mitur dhe **2** të rritur.

Paraqitje grafike



➤ Të dhëna për pasojat e veprave penale

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, nga të dhënat e gjendura në regjistrat fizike dhe elektronik, rezulton se pasojat kryesore të veprave penale janë ndaj pasurisë dhe kundër rendit e sigurisë publike.

Dëmet pasurore nuk janë të mëdha në vlera monetare, por ka një rritje të dëmtimeve në natyrë të sipërfaqëve pyjore të djegura.

Faktor negativ gjatë vitit 2024 ka qënë numri i lartë i viktimave në ngjarje të rënda kriminale dhe aksidente rrugore, ku janë regjistruar **6** viktime nga vrasjet dhe **16** viktime nga aksidentet rrugore.

V. TË DHËNA LIDHUR ME MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA DHE SEKSIONI E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE

➤ Ekstradimet

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, gjatë vitit 2024 janë regjistruar **4** praktika ekstradimi ndaj 5 shtetasve për të cilët kishte urdhëra kërkimi ndërkombëtar.

Kanë përfunduar të katërta praktikat ku janë konfirmuar dhe miratuar ekstradimet me vendim të gjykatës në **3** raste, për **1** rast është përfunduar dhe realizuar ekstradimi i një shtetasi drejt Italisë dhe **2** rastet e tjera janë ankimuar ne Gjykatën e Apelit.

Në **1** rast(shtetas iranian) është hequr dorë nga kërkesa pasi personi i ndaluar gëzonte statusin e refugjatit politik sipas Konventës së Refugjatëve të vitit 1951.

➤ Letërporositë

Gjatë vitit 2024 janë regjistruar **5** letërporosi nga autoritetet e huaja gjyqësore, të cilat janë administruar si më poshtë:

3 letër porosi janë ekzekutuar nga prokurori i seksionit.

1 rast i jemi drejtuar gjykatës për lejimin për marrje provash dhe pritet vendimi i aryetuar i gjykatës për ekzekutimin e letërporosisë.

1 letërporosi nga autoritetet greke mbetet e pa ekzekutuar për shkak të kompleksitetit të çështjes.

Gjatë vitit 2024 janë dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër drejt autoriteteve gjyqësore të huaja **7** letërporosi. Për të gjitha këto letërporosi kemi marrë konfirmimin se ato janë vënë në lëvizje nga strukturat kompetente.

➤ Njohet e vendimeve penale

Gjatë vitit 2024 është regjistruar **1** praktikë për njohjen e vendimit penal të huaj, kërkesë e ardhur nga autoritetet gjermane dhe është në fazë gjykimi në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.

➤ Tranferime procedimesh

Gjatë vitit 2024 është dërguar për transferim jashtë shtetit **1** procedim penal në ngarkim të një shtetasi gjerman për veprën penale “*Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike*”, parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal.

➤ Transferime të dënuarish

Gjatë vitit 2024 janë regjistruar **2** praktika për njohjen e vendimit penal të huaj dhe transferimin e të dënuarve me këto vendime. Nga këto praktika, **1** kërkesë nga Mbretëria e Bashkuar është përfunduar dhe personi i dënuar (shtetas shqipëtar) është transferuar.

Është realizuar **1** praktikë për transferimin e një shtetasi të huaj (izraelit) i dënuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, nga Shqipëria drejt Izraelit.

➤ Seksioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale

Gjatë vitit 2024 janë nxjerrë nga seksioni i ekzekutimit të vendimeve penale **164** urdhëra për ekzekutimin e vendimeve penale të formës së prerë, nga këto:

- **59** urdhëra ekzekutimi për dënime me burgim.
- **8** urdhëra ekzekutimi për dënime me gjobë.
- **89** urdhëra ekzekutimi për dënime alterantive sipas nenit 59 të Kodit Penal.
- **8** urdhëra ekzekutimi për dënime alternative sipas nenit 63 të Kodit Penal.

Nga të cilat janë vënë në ekzekutim:

- **58** urdhëra ekzekutimi për dënime me burgim.
- **2** urdhëra ekzekutimi për dënime me gjobë.
- **83** urdhëra ekzekutimi për dënime alternative sipas nenit 59 të Kodit Penal.
- **8** urdhëra ekzekutimi për dënime alternative sipas nenit 63 të Kodit Penal.

Kanë mbetur pa u ekzekutuar:

- **1** urdhër ekzekutimi për dënim me burg.
- **6** urdhëra ekzekutimi për dënime me gjobë.
- **6** urdhëra ekzekutimi për dënime alternative sipas nenit 59 të Kodit Penal.

Janë mbartur pa u ekzekutuar:

- **2** urdhëra ekzekutimi për dënime me burgim të përjetshëm.
- **28** urdhëra ekzekutimi për dënime me burgim.
- **2** urdhëra ekzekutimi për dënime alternative sipas nenit 59 të Kodit Penal.

Gjithashtu, nga prokurori i seksionit të ekzekutimit të vendimeve penale janë përfunduar në fazë ekzekutimi **39** praktika gjyqësore me objekt *shuarje dënimi, bashkime dënimesh, lirime me kusht, revokime vendimi me shërbim prove, për amnistinë, rivlerësim masash mjekësore*.

VI. TË DHËNA PËR NGARKESËN DHE TREGUESIT E PUNËS PËR PROKURORËT, SHEFAT E SEKTORIT, ZËVENDESPROKURORIN DHE DREJTUESIN E PROKURORISË

➤ Të dhëna për ngarkesën e punës për oficerët e policisë gjyqësore dhe zbatimin e sistemit SVHOPGJ

Gjatë vitit 2024 nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit të policisë së shtetit janë hetuar 250 procedime penale të deleguara nga prokurorët për kryerje veprimesh hetimore.

Gjatë vitit 2024 oficerët e Policisë Gjyqësore në seksionin e policisë gjyqësore të prokurorisë, në zbatim të urdhërimit të Prokurorit të Përgjithshëm për përditësimin e të dhënave në sistemin SVHOPGJP, ka rezultuar në hetimin e **1333** çështjeve, në total kryerjen e **2912** veprimeve hetimore.

Në tabelën e mëposhtë do të paraqiten të dhënat mbi ngarkesën dhe mënyrën e përfundimit të çështjeve.

Of.Pol.Gjyqësore	Total ne Hetim	Perfunduar per Gjykim	Perfunduar per Pushim	Perfunduar per Pezullim	Përfunduar pa relacion	Përfunduar	Mbetur ne Hetim
Martin Pali	8	0	2	0	0	2	6
Arjan Resnja	76	32	8	2	0	42	34
Agon Nakollari	153	68	51	9	0	128	25
Çlirim Puto	140	59	28	10	0	97	43
Erlin Lani	162	54	27	0	33	114	48
TOTAL	539	213	116	21	33	383	156

*Oficeri i Policisë Gjyqësore Martin Pali, ka ngarkesë çështjesh në hetim më të ulët në krahasim me oficerët e tjerë për shkak se është oficer i seksionit të ekzekutimit të vendimeve penale, kryen verifikimin dhe kthimin e përgjigjeve Prokurorisë së Përgjithshme, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe institucioneve të tjera. Gjithashtu oficeri Martin Pali punon edhe me çështjet e pezulluara ndër vite dhe të pushuara për shkak parashkrimi, ku ngarkesa e tyre gjatë 2024 ishte 262 çështje.

Çështje të përfunduara nga prokurorët dhe mënyra e përfundimit të tyre

Prokurori	Gjyqit	Pushuar	Pezulluar	Transferuar	Procedime penale të përfunduara	Mosfilluar	TOTAL PERFUNDUAR
Petrir Çano		262			262		262
Gazmend Frëngu	64	45	19	28	156	78	234
Denisa Plaku	83	41	31	16	171	79	250
Bledar Bala	46	42	23	34	145	93	238
Nertila Miftaraj	40	48	17	29	134	70	204
Maringlen Meta	53	28	20	23	124	46	170
Aulona Haxhiraj	17	14	13	12	56	21	77
Blerina Musabelliu	18	35	13	8	74	40	114
TOTALI	321	253	136	150	860	427	1287

Sipas të dhënave, rendimenti i prokurorisë gjatë vitit 2024 është 111%.

Gjatë vitit 2024 janë dërguar me kërkesë për pushim në gjykatë ose janë pushuar me vendim të prokurorit, **262** procedime penale të pezulluara ndër vite të cilat kanë kaluar afatin e parashkrimit të ndjekjes penale.

Gjatë vitit 2024 nga Komisariatet e Policisë dhe Drejtoria Vendore e Policisë janë përcjellë **226** materiale bazuar në Memorandumin e Bashkëpunimit PP-DPPSH, nga të cilat është vendosur arkivimi i praktikës për **194** materiale dhe për **32** materiale është vendosur regjistrimi në regjistrin e njoftimit të veprave penale.

Këto materiale janë shpërndarë sipas grafikut mujor të gatishmërisë për secili prokuror.

Ngarkesa e përballuar nga prokurorët ka qënë mesatarisht e lartë por dhe efikasiteti në zgjidhjen dhe trajtimin e çështjeve ka qënë i kënaqshëm.

Prioritet mbeten çështjet e mbartura nga vitit e kaluara dhe kryesisht ato të prokurorëve të larguar nga sistemi apo të transferuar në prokurori të tjera çka sjellin këto rezultate në efikasitetin e punës së prokurorëve por edhe të vetë Prokurorisë si institucion.

Bazuar në urdhërin e drejtuesit të prokurorisë është kryer inventarizimi fizik i procedimeve penale në hetim ku janë evidentuar se një pjesë e procedimeve që rezultonin të mbartura ishin përfunduar por nuk ishin kryer shënimet përkatëse dhe nuk ishin rakorduar në tabelën e statistikave çka sillte një ngarkesë jo reale të volumit të punës në prokurori.

VII. INFORMACION MBI ADMINISTRIMIN DHE VEPRIMTARINË ADMINISTRATIVE TË PROKURORISË

➤ Sektori i financës

Për vitin 2024 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokaster ka patur fonde buxhetore faktike ne shumen totale **99 867 211** leke te realizuara keto ne ndarjen e Artikujve si me poshte :

600 “Paga te personelit te perhershëm” ne shumen	71 397 179
601 “Kontribute te sigurimeve shoqerore “ ne shumen	8 165 733
602 “Mallra e sherbime” ne shumen	20 199 299
606 “Shpenzime te tjera” ne shumen	105 000
231 “Investime”ne shumen	0

Pjesen me te madhe e zene shpenzimet per honoraret ku perfishen shpenzimet per avokat, ekspert te ndryshem , perkthyes, sherbime kadastrale dhe shpenzimet për sigurine dhe ruajtjen fizike te objektit te Prokurorisë dhe gjykates se Rrethit Gjyrokaster dhe ruajtjen e ish godines se Prokurorisë Tepelene e cila eshte pershtatur per ambjente si arkive gjyqesore. Faturat ndaj te treteve jane shlyer ne kohe dhe gjendja ne fund te vitit per faturat e palikujduara eshte 885 465 leke qe i perkasin faturave mujore (dhjetor 2024). Për të gjitha rastet e gadishmërisë dhe mbikohës së punës të cilat janë evidentuar në menyre të plotë dhe kapin shifren 1269 orë për te cilen punonjësit e kësaj Prokurorie janë paguar. Ndersa per periudhen ne vazhdim ndryshimet gjate vitit, shtesat ose pakesimet jane bere me urdher te Prokurorit te Pergjithshem.

Struktura organike ne kete prokurori ka funksionuar sipas struktures se derguar nga Prokuroria e Pergjithshme me shkrese nr.160/13, date 31.01.2024, si më poshtë:

- *Drejtues i Prokurorisë – 1*
- *Zv.Drejtuesi i Prokurorisë -1*
- *Prokuror – 7*
- *Oficer të Policisë Gjyqësore – 7*
- *Kryesekretar – 1*
- *Përgjegjës i Sektorit të Financës – 1*
- *Sekretar – 5*
- *Specialist IT – 1*
- *Specialist arkive - 2*
- *Koordinator – 1*
- *Ftues – 1*
- *Shofer – 1*
- *Punonjës shërbimi – 1*
- *Sanitare – 1*
- *Punonjës me kontratë – 2*

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjyrokastër aktualisht ushtrojnë funksionin 7 prokurorë nga 9 që ka organika dhe 5 oficerë të policisë gjyqësore nga 7 që ka organika.

➤ Administrata

Është me vend të theksojmë edhe përkushtimin e treguar nga personeli administrativ i kësaj prokurorie, kryesekretari, sekretaret, punonjësit e shërbimeve mbështetëse dhe ata me kontratë, puna e të cilëve ka qenë mbështetje e rëndësishme për prokurorët dhe oficerët e Policisë Gjyqësore në ushtrim të detyrës së tyre, por edhe për qytetarët të cilëve u janë ofruar shërbime administrative të cilësisë së lartë.

Hedhja e të dhënave në sistemin CAMS për shortimin e çështjeve të reja është zbatuar me korrektesë përveçse gjatë muajit Gusht, muaj i cili përkon me lejen vjetore dhe çështjet e reja shpërndahen sipas grafikut të gatishmërisë, miratuar me urdhërin Nr.8, datë 29.07.2024 të Drejtuesit të Prokurorisë.

Respektimi i disiplinës dhe etikës nga punonjësit është korrekt dhe konform rregullave dhe dispozitave në fuqi.

➤ Kapacitetet infrastrukturore

Në lidhje me kapacitetet infrastrukturore kemi në përdorim katin e tretë të godinës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjyrokastër ku konkretisht janë 13 zyra që përdoren nga personeli dhe 1 dhomë provash. Në muajin Dhjetor 2024 janë marrë në përdorim nga godina e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjyrokastër 8 zyra të cilat ndodhen në katin e parë të godinës.

Në këto zyra është vlerësuar që të akomodohen oficerët e policisë gjyqësore, specialisti IT dhe koordinatorja dhe 1 zyrë do të përshtatet për ambientin e posaçëm të intervistimit të të miturve dhe personave me status të posaçëm.

Për ambientet shtesë dhe ato ekzistuese është e nevojshme të kryhet rikonstruksion godine, ku përfshihet investim në rrjetin elektrik, kompjuterik, pajisje zyrash, dyer, dritare si dhe sistemin e ngrohjes dhe ftohjes pasi janë të amortizuara dhe jo eficientë në konsumin e energjisë elektrike.

Gjithashtu është në përdorim edhe ambienti i godinës së ish-Prokurorisë Tepelenë e cila shërben si ambient për administrimin e materialeve të arkivuara.

Godinat ruhen nga shërbimet e Illyrian Guard, me sisteme syurvejimi kamerash dhe sisteme alarmi.

VIII. INFORMACION PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE MEDIAT

Gjatë vitit 2024, marrëdhëniet me publikun dhe mediat kanë qënë korrekte dhe brenda kornizave ligjore. Është treguar kujdes i verçante për te trajtuar me përparësi dhe efektivitet për tu ardhur sa me pare ne ndihme qytetareve per shqetësimet e ngritura nga palët në proces , është kërkuar në vazhdimësi që prokurorët të jenë korrekt me qytetarët, me vartësit, me kolegët, të ruajnë një figurë të pastër etiko-morale duke i shërbyer në radhë të parë vetes, por edhe ruajtjes së një imazhi të pastër të Institucionit.. gjithësesi fakti qe kete vit shte larguar nga detyra me vendim te Keshillit te Larte te Prokurorise nje

prokuror për shkelje të disiplinës në punë duhet të shërbejë si një kambanë alarmi që fenomene të tilla të mos ndodhin në të ardhmen. Në funksion të kësaj në zbatim edhe të Udhëzimit të Përgjithshëm “ *Per mardheniet me publikun*” prokurori i caktuar me këto detyra është përpjekur të bëjë transparencë për çështje sensitive që shqetësojnë komunitetin.

Gjatë vitit 2024, janë trajtuar nga koordinatori për të drejtën e informimit 25 kërkesa për informacion bazuar në ligjin Nr.119/2014, për të cilat është kthyer përgjigje brenda afate ligjore dhe në formë të plotë.


IX. OBJEKTIVAT SIPAS DREJTIMEVE PRIORITARE NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2025

Nga analiza në tërësi e elementëve që u përmendën më lart për vitin në vazhdim prioritet kryesorë do të jenë:

1. Implementimi me sukses i gjithë ndryshimeve në Kodin Penal dhe Kodin të Procedurës Penale duke duke i dhënë përparësi pavarësisht se prokurorëve në vendimarrje por edhe aplikimit të instituteve të reja të parashikuara në këto kode.
2. Përfundimi në një kohë sa më të shkurtër i të gjitha çështjeve të mbartura ndër vite dhe për vitin 2025 do të nxirret një udhëzim për mënyrën e trajtimit dhe përfundimit të tyre në një kohë sa më të shpejtë, duke shmangur zvarritjen e më tejshme të tyre.
3. Marrja e masave procedurale dhe ndjekja e krimeve zgjedhore në kuadër të zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare të cilat zhvillohen më datë 11.05.2025.
4. Përfundimi i procedimeve penale të “*Pastrimit të produkteve penale ose veprimtarisë kriminale*” dhe Hetimeve Pasurore, ku gjatë vitit 2025 pritet të kryhen analizat financiare në bazë të të cilave do të procedohet me mënyrën e përfundimit të këtyre çështjeve.
5. Vazhdimi i ndjekjes me përparësi të procedimeve penale në fushën doganave dhe kufitare, kontrabandimit të emigrantëve të paligjshëm, shitjes, shpërndarjes dhe trafikimit të lendeve narkotike, kultivimit të bimëve narkotike ku ka rezultuar se në vitet e fundit lufta ndaj këtij fenomeni ka dhënë frytet e veta duke ulur ndjeshëm rastet e kultivimit në qarkun Gjirokastrë, veprat penale në fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit, abuzimit me detyrën të nëpunësve shtetërorë, veprat penale kundër jetës, shëndetit, veprave penale të kalëzuara nga ILDKPI, Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Sektori i Verifikimit të Integritetit të Personave të Zgjedhur në Prokurorinë e Përgjithshme, veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes me objekt të vecantë veprat penale kundër dhunës në familje, veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike, në veçanti shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor, krimet mjedisore ku në qarkun Gjirokastrë ndodhen parku Kombëtar i “Lumit të Vjoses” ku përfshihen luginat e lumenjve Drino dhe Bençe, parku Kombëtar i “Bredhit të Hotovës”, zonat e mbrojtura natyrore, muzeale e arkeologjike dhe çdo lloj forme tjetër të krimit që konsiderohet shqetësuese për komunitetin ku ushtrojmë detyrën.
6. Trajtim rigoroz i çështjeve me autore dhe viktimë të Mitur duke u dhënë përparësi interesit me të lartë të tyre, duke respektuar të gjitha rregullat e parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur dhe duke zbatuar një politikë ndjekje penale dhe denimi që ti shërbejë edukimit dhe integritetit të tyre në shoqëri.

7. Rritja e numrit të hetimeve proaktive dhe përdorimit të teknikave speciale të hetimit , kryerja e hetimeve sistematike pasurore për të gjitha rastet e parashikuara në ligj me synim sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive me burime kriminale.
8. Ndjekja në vazhdimësi e çështjeve për ngjarje kriminale të rënda si dhe kryerja e veprimeve proaktive dhe me metoda speciale për parandalimin e përshkallëzimit dhe zbardhjes së plotë të ngjarjes me 3 persona të vrarë në qytetin e Memaliaj dhe vendosja e autorëve përpara përgjegjësisë penale.
9. Çështjet e pezulluara në vitet e mëparshme dhe në këte kuader forcimi i bashkëpunimit me Policinë Gjyqësore dhe organet e tjera ligjzbatuese me qëllim për të mos lejuar askënd t'i shpëtojë ndëshkimit ligjor për veprat e kryera.
10. Rritja e funksionit drejtues dhe kontrollues të prokurorit në hetimet paraprake të kryera nga Shërbimet e Policisë Gjyqësore.
11. Përmirësimi i organizimit, drejtimit dhe kontrollit brenda organit të Prokurorisë në përputhje me Ligjin nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe “Rregullores Standarte të Organizimit dhe Funksionimit të Prokurorisë të Juridiksionit të Përgjithshëm” për tu pershtatur me ndryshimet e këtij ligji me synimin për t’ju përgjigjur në kohë dhe me cilësi kërkesave të luftës kundër kriminalitetit, forcimit të disiplinës së brendshme dhe të vullnetit për të identifikuar çdo lloj problematike brenda organit dhe për ta goditur atë përpara se të ndodhë.
12. Respektimi i detyrimeve të ligjit procedural penal, rekomandimeve të Keshillit të Ministrave për luftën kundër kriminalitetit dhe Udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm në këte drejtim.
13. Forcimi i bashkëpunimit ndër-institucional sidomos me Prokurorinë Kunder Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit me qëllim shkëmbimin në një kohë sa më të shpejtë të informacionit për goditjen në kohë të të gjithë rasteve korruptive, me Policinë e Shtetit por edhe me të gjitha organet e tjera ligjzbatuese.
14. Rritja e profesionalizmit të prokurorëve kjo nëpërmjet ndjekjes së trainimeve vazhduese në Shkollën e Magjistratës si dhe ruajtja e një figure morale të pastër jashtë çdo ndikimi për të përfaqësuar në mënyrë dinjitoze Institucionin në raport me publikun, brenda dhe jashtë orarit të punës.

Gjirokaster, më 28.02.2025


DREJTUESI I PROKURORISË
PETRIT ÇANO
